ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES KACANIK**

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **_652-24-4439-1-2-1**

Numri i brendshëm : **KA652/24/30/121**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për **Furnizim me aparatur mjeksore për nevojat e Laboratorit të QKMF-së - Kaçanik** *(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)*

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

GOE . GENIUS KOSOVA; MADEKOS

Ferizaj

Vendi

70 000

Kodi postar

Valdete Neziri

Pronari

genius.ks@outlook.com

e-mail

14.05.2025

(Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K. GENIUS KOSOVA FERIZAJ

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi per kontrate: 07.05.2024
Hapja e ofertave: 29.05.2024
Kerkesa per rishqyrtim: 02.04.2025
Vendimi I refuzimit te Kerkeses per rishqyrtim: 05.05.2025
Kriteri i dhenies: Tenderi i pergjegjshem me cmim me te lire.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					Jo	X	

Nuk eshte bere hapja e ofertave, por kerkesa per rishqyrtim eshte bere ne kritere

5. **Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	x				Jo	

Jemi njoftuar permes letres standarde

6. **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura te LPP-se:

Neni 7 – Barazia ne trajtim / jo diskriminimi

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 62 – Perfundimi I aktivitetit te prokurimit

Neni 67.6 – Vendimi I OSHP-se (Rregullorja 01/2022 per Prokurim Publik)

Vendimi i OSHP nr. 2024/1225 i dates 05.02.2025

Neni 108A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK-Komuna e Kaçanikut ne aktivitetin e prokurimit **Furnizim me aparatur mjeksore për nevojat e Laboratorit të QKMF-së - Kaçanik, *me nr.prok.* 652-24-4439-1-2-1**

Me date 02.04.2025 kemi bere kerekese per rishqyrtim per anulimin e aktivitetit te prokurimit duke mos respektuar Vendimin e OSHP-se, kurse AK me date 05.05.2025 nxjerr Vendimin per refuzim te kerkeses per riishqyrtim duke kaluar me shume se 1 muaj, ku afati per trajtim te kerkeses per rishqyrtim eshte 3 dite. Pra, me kete veprim AK ben shkeljen e nenit 108A te LPP-se.

Sa I perket anulimit te aktivitetit te prokurimit AK ka bere shkeljen e vendimit te OSHP-se, qe po ua paraqesim si me poshte:

Lidhur me aktivitetin e larteshenuar ju si AK-Komuna Kaçanik, keni anuluar aktivitetin duke u arsyetuar se nuk keni te planifikuar buxhet ne vitin 2025.

Arsyetimi I AK-se per anulim te aktivitetit eshte I pabazuar pasi qe nuk e keni zbatuar vendimin e OSHP-se nr.1225/2024 I dates 05.02.2025, qe eshte pranuar I bazuar sipas ankeses qe kemi bere ne Organin Shqyrtues te Prokurimit.

Citim I vendimit:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE " GENIUS KOSOVA " SH.P.K. me nr. 2024/1225 , e datës 16.12.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me aparatur mjeksore për nevojat e Laboratorit të QKMF-së - Kaçanik me numër të prokurimit 652-24-4439-1-2-1.

2. AnulohetB58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Furnizim me aparatur mjeksore për nevojat e Laboratorit të QKMF-së - Kaçanik me numër të prokurimit 652-24-4439-1-2-1 kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik " GENIUS KOSOVA " SH.P.K.

Poashtu lidhur me moszbatimin e vendimit Brenda afatit kohor 10 ditor keni bere shkelje ligjore, sepse mos zbatimi I nje vendimi sic eshte OSHP, e deshmon shkeljen e vazhdueshme qe po beni ju si AK.

Vendimi I AK-se eshte marr me date 05.02.2025 dhe ka qene dasht te zbatohet deri me date 15.02.2025, kurse Autoriteti Kontraktues Komuna Kaçanik e ka publikuar vendimin per anulim te aktivitetit me 01.04.2025 afro dy muaj pas marrjes se vendimit, ku nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-se qe ne afat prej 10 diteve te zbatohet vendimi.

Ky mos zbatim vendimi mund te revokon certifikaten e prokurimit per zyrtarin pergjegjes te prokurimit te AK-se.

Prandaj keni shkelur nenin 67.6 te Rregullores 02/2024 qe thote (citim):

OSHP do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim mbi arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat është marrë një vendim i tillë, dhe ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë.

Prandaj, ju si AK nuk e keni zbatuar nje vendim te tille!

Ju si AK- Komuna Kacanik I keni shkelur te gjitha dispozitat ligjore te LPP-se dhe Rregullores se Prokurimit Publik, duke e anuluar njeanshem, duke shkelur nenin 62 te LPP-se (Perfundimi I aktivitetit te prokurimit).

Aktiviteti i prokurimit mund te perfundohet ne keto raste: kur ofertuesi/t kane ofertuar mbi buxhetin e planifikuar te AK-se, dhe ne rastet kur te gjitha ofertat jane te papergjegjshme, poashtu mund te anulohen edhe para hapjes se ofertave(konkretisht 3 dite para hapjes).

Pra, asnjeri kusht nuk eshte arritur per tu anuluar aktiviteti, andaj ky veprim I AK-se bie ne kundershtim me nenin 7 te LPP-se (diskriminimi jone nga ana e AK-se) dhe nenin 59.4 te LPP-se (pasi qe oferta jone eshte e pergjegjshme) poashtu edhe kemi çmimin me te lire dhe ju si AK pasi qe e keni rekomanduar per kontrate OE me cmim me te shtrenjte, dhe pas kthimit te lendes ne rivleresim nga ana e OSHP-se sipas vendimit 2024/1225 te dates 05.02.2025, ju si ZPP e anuloni aktivitetin e prokurimit padrejtesisht duke na diskriminuar neve si OE I pergjegjshem dhe duke e anuluar aktivitetin.

Ju si AK keni pasur Deklarate te nevojave per Disponueshmerine e Mjeteve, qe ato mjete nese nuk shpenzohen nuk humbin nga buxheti, vetem nderrohet destinimi nga buxheti komunal ne buxhet shteteror, andaj nuk eshte aspak ligjore te beni anulimin e aktivitetit.

Prandaj, AK ne rast se e publikon nje aktivitet prokurimi dhe ben hapjen – vleresimin e ofertave nuk mund te anulon aktivitetin kur te deshiron por duhet te kete arsye sipas nenit 62 te LPP-se per perfundim te aktivitetit te prokurimit.

Andaj, permes kesaj kerkese per rishqyrtim kerkoje qe te beni anulimin e vendimit per anulim dhe te beni kthimin e lendes ne rivleresim dhe te rivleresoni aktivitetin sipas nenit 59 te LPP-se, pasi qe I plotesojme te gjitha kriteret e kerkuara dhe jemi OE I pergjegjshem sipas nenit 59.4 te LPP-se.

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit" .

Pasi qe jemi OE I pergjegjshem sipas vendimit te OSHP-se eshte konstatuar nga Paneli Shqyrtues ne vendimin 2024/1225 I dates 05.02.2025

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me aparatur mjeksore për nevojat e Laboratorit të QKMF-së - Kaçanik me numër të prokurimit 652-24-4439-1-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërsi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pra, ne jemi OE me i lire se OE i rekomanduar dhe AK me keto veprime e demton buxhetin publik, duke e rekomanduar per kontrate nje OE me cmim me te shtrenjte..ku AK ben shkeljen e nenit 1 dhe 6 te LPP-se, duke na diskriminuar sipas nenit 7 te LPP-se dhe duke bere shkeljen e nenit 59 te LPP-se dhe nenit 69 te LPP-se.

Kerkojme nga ju si OSHP qe te vleresoni sipas kritereve te kerkuara te dosjes ashtu siq e sqaron edhe **Neni 56.3 i LPP-se** qe thote: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Lidhur me mos zbatimin e OSHP-se kerkojme nga paneli shqyrtues qe per mos zbatim te vendimit te revokohet licenca e Zyrtarit Pergjegjes te Prokurimit sipas nenit 25 te LPP-se.

Konform dispozitave ligjore te LPP-se dhe kritereve ne dosje, permes ankeses OSHP te kthej lenden ne rivleresim dhe te veprohet sipas kritereve te dosjes.

Per padrejtesi ndaj neve si OE do te detyrohemi ti drejtohemi organeve kompetente per zbatim te ligjit dhe te merret parasysh ankesa jone qe eshte e bazuar ne dispozitat ligjore te LPP-se.

Andaj, ne si OE ankues, duke u bazuar ne provat e paraqitura si me larte, kerkojme nga OSHP qe te merret paraysh ankesë dhe te merr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa per **ANULIMIN** e vendimit per anulim të aktivitetit,

RIVLERESIM I aktivitetit pasi qe jemi OE I pergjegjshem me çmim me te lire sipas vendimit te **OSHP-se nr.2024/1225 I dates 05.02.2025**

SHPERBLEHEMI me kontrate, pasi qe jemi OE i pergjegjshem me cmim me te lire sipas kritereve te FDT-se

8. Dëmet material

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Demet e shkaktuara gjer me tani ne pergatitjen e dosjes dhe shpenzimet e tjera kapin shumen deri ne 2,500 €

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*